

Besimi dhe morali i kohëve të vështira

Krejt në fillim i shpreh keqardhjen time të thellë popullit tonë, botës islame si dhe mbarë njerëzimit për këtë proces të vështirë në të cilin jemi duke kaluar.

Po ashtu dua të shpreh lutjet e mia të përzemërta për të gjithë mjekët dhe punëtorët e tjerë të shëndetit, të cilët në këto ditë luftojnë me mish e me shpirt kundër kësaj epidemie; për të gjithë ata që shërbimin e dinë si pjesë të adhurimit (*ibadetit*) dhe përkundër rrezikut që i nënshtrohen ata ua plotësojnë nevojat elementare atyre që nuk mundën; për të gjithë ata të moshuar që e mbështesin këtë proces duke ndenjur nëpër shtëpitë e tyre.

Sot është koha për të dëgjuar fjalët e autoriteteve të shëndetit. Të dëgjosh këshillat dhe rekomandimet e tyre, në fakt, është edhe një urdhër i fesë sonë të lartë. Sepse ruajtja e shpirtit, amanetit të Zotit, sot është detyra jonë më e shenjtë. Sot, edhe ruajtja e vetvetes por edhe kujdesi për të mos i infektuar të tjerët duke ndenjur nëpër shtëpitë tona është pothuajse si një qëndrim në istikame kundër armikut.

Javën e kaluar, këtu në hapësirat e institutit tonë (Instituti i Mendimit Islam), mbajtëm një ligjëratë me titull *Metodologjia e Kuptimit të Fatkeqësive nga Këndvështrimi Islam*. Ndërsa sot, duke e marrë parasysh edhe kohën nëpër të cilën po kalojmë, si një vazhdimësi e asaj të parës, do të mundohem t'i shtjelloj tri çështje me rëndësi:

E para, në këto kohë të vështira çfarë nënkupton *imani* (besimi) i kohëve të vështira, çfarë nënkupton *ahlaku* (morali) i kohëve të vështira?

E dyta, si mund ta forcojmë sistemin e imunitetit tonë shoqëror dhe shpirtëror gjatë këtij procesi? Cilat janë detyrat tona të secilit në këto kohëra? Le të kujtojmë shkurt se këtu të gjithë ne kemi detyrat tona si shoqëri, si familje, si individë etj.

E treta, si një familje e madhe njerëzore që jemi, si mund që këtë proces ta përkthejmë në *rahmet*, në mëshirë.

E di, sot nuk është dita për të dhënë mësim, por për të nxënë mësim të gjithë ne. Sot nuk është dita për t'u qarë e ankuar, por është dita e shërimit të derteve dhe e largimit të sikleteve tona. Unë shpresoj që, me anë të këtyre fjalëve të mia, sadopak të ndihmoj në zbutjen dhe tejkalimin e këtyre derteve.

Po, njerëzit përjetojnë ditë të vështira. Popujt kanë ditët e tyre të vështira. Shoqëritë po ashtu. Mirëpo sot, ndoshta për herë të parë, mbarë njerëzimi nga lindja e perëndimi, nga veriu e jugu, të varfër e pasanikë, pa dallim të statusit social, të gjithë ne jemi duke kaluar nëpërmjet një procesi dhe një kohe të vështirë.

Kur Kur'ani fisnik e trajton njeriun e kohëve të vështira, ai i përmend dy koncepte: (الْبَأْسَاءُ وَالضَّرَاءُ), [el-A'raf, 7:94.], pra skamjen dhe vështirësinë. Këto nënkuptojnë luftërat, skamjet, urinë, belatë, fatkeqësitë, sëmundjet, epidemitë... dhe në ajetet ku përmenden këto koncepte, aty flitet edhe për besimin e kohëve të vështira, por edhe për moralin e kohëve të vështira.

Besimi i kohëve të vështira nënkupton kthimin kah Zoti me një shpresë të madhe.

Besimi i kohëve të vështira nënkupton përçimin e shpresës dhe të gëzimit të njerëzit.

Besimi i kohëve të vështira nënkupton që assesi të mos na kaplojë dëshpërimi dhe zhgënjimi.

Besimi dhe parimi më i rëndësishëm i kohëve të vështira është që të mos lejojmë të na mbërthejë mungesa e shpresës dhe dëshpërimi. Humbja e shpresës në kohë të vështira është një sjellje që nuk i ka hije besimtarit. Kur’ani e përmend njeriun në këto ajete duke e bërë krahasimin e dy gabimeve të tij. Një, llastimin e tij në kohë të kamjes dhe të lehtësisë, dhe dy, humbjen e shpresës në kohë të vështirësisë dhe të mërziisë. Të dyja këto shihen si gabime të njëjta, të dyja kritikohen në shumë vende në Kur’anin fisnik.

Në suren el-Isra’ thuhet:

وَإِذَا أَنْعَمْنَا عَلَى الْإِنْسَانِ أَعْرَضَ وَنَأَى بِجَانِبِهِ وَإِذَا مَسَّهُ الشَّرُّ كَانَ يَكُفِّرًا ﴿٨٣﴾

“Kur e begatojmë (me të mira) njeriun, ai prapësohet dhe largohet i mashtruar; e kur e godet e keqja, ai e humb shpresën.” (el-Isra’, 17:83)

Në suren er-Rum kjo sjellje kritikohet në këtë mënyrë:

وَإِذَا أَدْقْنَا النَّاسَ رَحْمَةً فَرَحُوا بِهَا وَإِنْ تُصِيبُهُمْ سَيِّئَةٌ بِمَا قَدَّمَتْ أَيْدِيهِمْ إِذَا هُمْ يَفْطُونُ ﴿٣٦﴾

“Kur Ne u japim njerëzve begati të mira, ata u gëzohen atyre, e nëse ata i godet ndonjë e keqe për shkak të veprimit të tyre, atëherë ata e humbin shpresën.” (er-Rum, 30:36)

Edhe në suren Fussilet theksohet e njëjta gjë:

لَا يَسْأَلُ الْإِنْسَانُ مِنْ دُعَاءِ الْخَيْرِ وَإِنْ مَسَّهُ الشَّرُّ فَيَكُفُّ قَنُوطٌ ﴿٤٩﴾

“Njeriu nuk mërzhitet kurrë duke e kërkuar të mirën (te Perëndia), e nëse e godet e keqja, ai menjëherë bie në dëshpërim dhe e humb shpresën.” (Fussilet, 41:49)

Ja pra, ky është besimi i kohërave të vështira. Besimtari në këto kohë nuk e humb shpresën, porse duke iu kthyer Zotit, me një rezistencë dhe qëndrueshmëri të madhe ai mundohet t’i ndryshojë këto rrethana.

Në të njëjtat ajete flitet edhe për *ahlakun*, moralin e kohërave të vështira.

Morali i kohërave të vështira është morali i mirësisë, është morali i dhënies përparësi të tjerëve, është morali i dhënies lëmoshë, është morali i faljes, është morali i durimit. Të gjitha këto përmenden në të njëjtat ajete kur’anore.

Morali i kohëve të vështira është *ihsani*, mirësia. *Ihsani* nënkupton sjelljen me mirësi kundrejt çdo të keqe që na godet. Nënkupton lehtësimin e punës. Në këto kohë të vështira nënkupton që në asnjë mënyrë të mos lejojmë që vëllai ynë apo motra jonë të bien për tokë.

Morali i kohëve të vështira është *ithari*. Çfarë nënkupton shprehja *ithar*? Në çdo rast t’i japim përparësi tjetrit, vëllait apo motrës sonë përpara vetvetes. T’i japim përparësi fqinjit përpara vetvetes.

Morali i kohëve të vështira është dhënia e lëmoshës. Të ndajmë me të tjerët gjithçka që mund të ndajmë.

Morali i kohëve të vështira është falja. Gjithnjë të falim, të ndreqim, të kemi ndjesë ndaj gabimeve të të tjerëve.

Morali i kohëve të vështira është *sabri*, durimi. Durimi, durimi i Kur’anit, nuk nënkupton palosjen dhe strukjen, por qëndresën; mos humbjen e qëndresës dhe rezistencës kundrejt gabimeve, të këqijave dhe fatkeqësive.

Të gjitha këto përmenden në ajetin e famshëm Kur’anor i cili e përkufizon të mirën sade, të mirën e kulluar:

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٣٤﴾

“(Xhenneti i gjerë sa qiejt e toka është përgatitur për ata) *të cilët japin lëmoshë kur janë në lumturi edhe kur janë në vështirësi, që e frenojnë zemërimin, e ua falin fajet njerëzve. Se All-llahu i do bamirësit!*” (Alu Imran, 3:134)

Tema e dytë që dëshiroj ta trajtoj këtu është sistemi i imunitetit tonë shoqëror dhe shpirtëror. Sigurisht që këto ditë, me ndihmën e All-llahut xh.sh., do të kalojnë. Mirëpo, sjelljet e virtutshme dhe të moralshme që do t'i fitojmë në këto ditë do të ngelin.

Sa është me rëndësi që ta mbajmë gjallë dhe të fuqishëm sistemin e imunitetit tonë fizik përgjatë këtij procesi, po aq, bile edhe më shumë se kaq, ka rëndësi që ne si popull e si mbarë njerëzim ta forcojmë sistemin e imunitetit tonë shpirtëror, mental dhe social.

E dimë që në këto kohëra ta ruash amanetin e Zotit, shpirtin apo jetën, është njëri prej urdhrave të Tij më të mëdhenj. Këtë e theksova edhe në fillim.

Mirëpo, duke u munduar që nga njëra anë ta ruajmë trupin tonë, nga ana tjetër ne duhet të përpiqemi që të mos e humbim edhe unitetin, bashkimin dhe vëllazërinë tonë.

Nga njëra anë ne kujdesemi për distancën fizike/sociale. Këtë na rekomandon sot gjithsecili. Mirëpo, nga ana tjetër, të mos e lëmë pas dore afrimin dhe bashkimin e zemrave. Nga njëra anë e mbajmë veten larg afrimit fizik, madje as edhe nuk përshëndetemi për dore. Mirëpo, nga ana tjetër, gjatë këtij procesi ne duhet ta rrisim afërsinë e zemrave e të shpirtit.

Nga njëra anë ne e ngulojmë vetveten në karantinë si individë, dhe këtë na rekomandojnë edhe autoritetet. Këtë duhet bërë. Mirëpo, nga ana tjetër duhet të tregojmë përpjekjet tona maksimale edhe për ruajtjen e unitetit dhe të gjallërisë sonë shoqërore. Duhet të largohemi nga çdo lloj diskursi përjashtues e tëhuajësues. O sot o kurrë kemi nevojë për paqe e qetësi sociale.

Në këto ditë duhet t'i lëmë pas shpine të gjitha fërkimet dhe polarizimet që mund t'i kemi përjetuar në të kaluarën e afërt e të largët.

Kjo fatkeqësi, herët a vonë, do të kalojë, inshallah. Mirëpo, plagët e zemrës të shkaktuara në këto kohë, nuk mbyllen kollaj. Prandaj, të bëjmë kujdes dhe të mos hapim plagë të reja zemre!

Familja e madhe njerëzore, në procesin e tejkalimit të këtyre mynxyrave, çdo kund, çdo institucioni dhe çdo individ i ngarkon detyra dhe përgjegjësi të caktuara. Le ta theksojmë edhe njëherë se këtë vështirësi e siklet mund ta kalojmë vetëm bashkë. Sot, secili prej nesh, qofshim edhe nëpër shtëpitë tona, kemi detyrat dhe përgjegjësitë tona njerëzore, islame dhe morale.

Fillimisht *vëllazërve tanë të pasur* u takojnë detyra të mëdha në këto kohë. Sepse ne të gjithë e dimë se kemi me miliona njerëz të cilët jetesën e tyre e fitojnë me pagë ditore dhe se sot ata janë të detyruar të mbyllen nëpër shtëpitë e tyre. Këto ditë nuk janë ditë kursimi dhe tubimi, por janë ditë ndarjeje dhe shpërndarjeje. Këto janë, siç thotë Zoti në Kur'an, ditët kur *“besimtarët shpërndajnë nga ajo që Ne ua kemi dhënë.”* (esh-Shura, 42:38) Këto janë ditët kur ne ia duam tjetrit atë që ia duam edhe vetvetes. Janë ditët kur ne i kujtojmë të tjerët aq sa e kujtojmë edhe vetveten. Sigurisht që këto ditë do të kalojnë me ndihmën e Zotit. Mirëpo, të mirat dhe virtutet që do t'i përvetësojmë sot, do të ngelen përgjithmonë. Lutja ime drejtuar vëllazërve tanë pasanikë është: shtoni *du'atë* apo lutjet tuaja aktive, vepruese! Çfarë mund të bëni?! Paguajani qiranë atij që nuk mund ta paguajë; paguajani rrogën e plotë punëtorit edhe pse në këto ditë ai nuk punon sepse ju e keni mbyllur punëtorinë apo fabrikën tuaj; paguajeni *zekatin* për vitet që ndoshta ju kanë ngelur pa e paguar, etj.

Në këtë proces jeta jonë familjare kërkon një kujdes dhe rëndësi shumë më të madhe. Në këto ditë që jemi të detyruar të mbyllemi nëpër shtëpitë tona, le ta kthejmë këtë izolimin tonë në një izolim aktiv sikur ta kryejmë *ibadetin* e *i'tikafit* (vetëveçimit në xhami për të kryer akte adhurimi), që përmendet në Kur'an dhe që zbatohet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit! Ky le të jetë një izolim dhe ngujim aktiv, e jo pasiv. Pra, për ta kapërcyer këtë fatkeqësi, secili prej nesh, aty ku jemi, do ta kryejmë çdo detyrë që lypet prej secilit prej nesh. Shtëpitë tona që i kemi kthyer në istikame kundër kësaj fatkeqësie, ne mund t'i kthejmë në shtëpi e fole të lumturisë së të dyja botëve. Sot gjithandej po qarkullon një slogan i bukur: shtëpia e nxë tërë jetën. Po, e nxë, ama jo vetëm jetën e kësaj bote. Në shtëpitë tona ka vend edhe për jetën e amshueshme të botës tjetër, ahiretit. Le t'u bëjmë vend nëpër shtëpitë tona të dyja botëve!

Autenticitetin e botës digjitale mund ta kthejmë në realitet, duke i përdorur po të njëjtat mundësi të kësaj bote, për t'u interesuar për hallin dhe gjendjen e miqve tanë, të të afërmeve dhe fqinjëve tanë. Duke i përdorur mundësitë e komunikimit të kohës sonë, ne mund që shtëpitë tona t'i kthejmë në mejtepe e shkolla të dijes dhe të njohjes. Le ta kujtojmë edhe një herë urdhrin e Zotit drejtuar Musait a.s. dhe vëllait të tij Harunit a.s.: (وَأَجْعَلُوا بُيُوتَكُمْ قِبْلَةً) "*Shtëpitë tuaja t'i bëni faltore!*" (Junus, 10:87) Pikërisht tani është koha për këtë.

Në këtë proces dua që disa fjalë t'ua drejtoj edhe të rinjve e të rejave muslimane.

Në këto kohë të vështira edhe juve ju takojnë disa përgjegjësi shumë me rëndësi. Duke u kujdesur për vetveten tuaj në këto kohë të pakohë, assesi të mos i harroni më të moshuarit! Diluni zot atyre! Në veçanti të tregojmë kujdes ndaj atyre që në këto ditë nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre! Nga njëra anë le të lexojmë e të përgatitemi për të ardhmen tonë, e nga ana tjetër le të përfitojmë nga përvoja e më të moshuarve!

Në këto kohë të zahmetshme, si një koleg kam disa fjalë edhe për hoxhallarët, të cilët janë të angazhuar në udhëzimin dhe orientimin e shoqërisë.

Të nderuar hoxhallarë!

Si në çdo çështje tjetër, as edhe në këtë të mos e bëjmë të njëjtin gabim. Këtë jua e them, edhe pse e di se nuk më takon mua t'ju mësoj. Kur t'i vlerësojmë këto fatkeqësi, të mos ngutemi e t'i interpretojmë ato siç bëjnë disa duke i quajtur ato herë si *dabbetu'l-ard* (kafsha që del nga toka, si shenjë e madhe e kijametit), herë si *je'xhuxh* dhe *me'xhuxh* (po ashtu shenjë e madhe e Kijametit), herë si mallkim e ndëshkim nga Zoti, e herë si shkatërrim dhe shfarosje nga Zoti. Ju lutem, të mos ndahemi nga dija e urtësia dhe – ashtu siç shprehet Kur'ani: رَجْمًا بِالْغَيْبِ (el-Kehf, 18:22) – të mos flasim me tahmin, me hamendje!

Në këto sëmundje kaq të mëdha, të nderuar hoxhallarë, të mos lejojmë që edhe fetaria jonë të bartë sëmundje shtesë! Të mos veprojmë nga një këndvështrim i vockël i botës dhe i dijes! Le të shikojmë në mënyrë më të plotë, më të tërësishme! Ajetet kozmike dhe ajetet e shpallura siç janë Kur'ani, sunneti etj. le t'i trajtojmë e vlerësojmë së bashku. Në këto kohëra aspak nuk është me vend të bëjmë teologji teorike. Nëse e shikojmë historinë, katastrofat e mëdha në të njëjtën kohë kanë shkaktuar edhe shfaqjen e besimeve të kota që e kanë prishur besimin e mirëfilltë.

Ka një kohë të gjatë që jemi dëshmitarë të diskutimeve fetare nëpër mediet sociale të cilat herë-herë janë shumë lënduese. Këto le t'i lëmë mënjatë! Sot nuk është koha të bëhemi mësues të shkencës së *kelamit* (teologjisë), por mësues të shpresës.

Këtu në botën e sprovave tanimë është e vërtetë se jemi përballë një epidemie botërore të mbushur me mësim e paralajmërime. Në qoftë se ne si hoxhallarë e si dijetarë e shfrytëzojmë këtë rast për t'i orientuar dhe udhëzuar njerëzit drejt Zotit të vërtetë, nuk mund ta bëjmë këtë duke i frikësuar ata me një zot frike të imagjinuar. Askush nuk ka të drejtë që Zotin tonë të

Mëshirshëm e Mëshirëplotë ta paraqesë si një perëndi që nga qielli lëshon zemërimin dhe dënimin e tij mbi robërit e tij në tokë. Këtë dua ta theksoj qartë. S'është aspak e drejtë që mësimeve dhe paralajmërimeve të *sunnetullahit* (ligjeve të Zotit në gjithësi) t'ua humbim kuptimin e vërtetë të tyre, duke i lënë në hije me anën e një diskursi apokaliptik, të kohës së Kijametit.

Zoti ynë gjithësinë e drejton dhe e sundon me cilësinë e tij *er-Rahman* (i Gjithëmëshirshmi). Ai thotë në Kur'an: *كُتِبَ عَلَيْكُمُ عَلَىٰ نَفْسِهِ الرَّحْمَةُ* - "Zoti juaj ia ka caktuar (ngjeshur) vetvetes *mëshirën*." (el-En'am, 6:54) Zoti ynë nuk u jep mirësi vetëm atyre që i besojnë dhe që janë të bindur. Ai u jep edhe atyre që ngrenë krye dhe rebelohen kundër Tij. Ndonjëherë këtyre të fundit u jep më shumë. Këto mesele duhet t'i sqarojmë dhe interpretojmë duke i pasur parasysh të gjitha këto që u thanë.

Detyrë e dijetarëve muslimanë sot është që të merren sidomos me pyetjet e reja dhe aktuale të rinisë. Ata kanë pyetje shumë serioze rreth çështjes së të keqes. Për ta duhet të përgatisim përgjigje shkencore. Ne duhet ta mbështesim dhe arsyetojmë mirë dhe drejtë raportin midis këtyre të këqijave dhe mëshirës si dhe drejtësisë së Zotit. (Insha'allah në njërën prej ligjëratave tona të ardhme do ta trajtojmë këtë temë bashkë me të rinjtë.)

Detyrë e dijetarëve muslimanë sot është që të mendojnë se çfarë ndikimi do të ketë bota e pas-coronës mbi fenë tonë islame? Jeta fetare dhe shpirtërore e njerëzve si do të ndikohet nga ky proces? Qysh tani ne, të gjithë së bashku, duhet t'i trajtojmë në mënyrë shkencore këto dhe temat e ngjashme me to.

Për në fund, ne si familje e madhe botërore si mund ta përkthejmë këtë proces në mëshirë?

Në ajetin 216 të sures së dytë el-Bekara, All-llahu xh.sh. thotë:

... وَعَسَىٰ أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ وَعَسَىٰ أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا وَهُوَ شَرٌّ لَّكُمْ ...

"... Ju mund ta urreni një gjë, e ajo të jetë e dobishme për ju, dhe ju mund ta doni një gjë, e ajo të jetë e dëmshme për ju..."

Ndoshta kjo botë, të cilën e kemi lodhur kaq shumë, ka nevojë për pak qetësi. Vërtet shumë e kemi lodhur natyrën, e kemi përdorur atë në mënyrë shumë të ashpër dhe të papërgjegjshme. Ndoshta tani e tutje duhet më shumë se kurrë të flasim për të drejtën e natyrës dhe për përgjegjësitë që ne i kemi ndaj saj. Tani është koha të mendojmë rreth asaj se në ç'masë ia kemi shkelur të drejtat natyrës.

Ngase Zoti ynë atje ka vënë një peshore, një baraspeshë:

وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ ﴿٧﴾

"Kurse qiellin e ka ngritur dhe në të ka vendosur peshojën, baraspeshën." (er-Rahman, 55:7)

Në qoftë se priset baraspesha që e ka vënë Zoti, natyra jonë do të lodhet e rraskapitet, njerëzimi do të sëmuret, ujërat do të ndoten, ushqimi do të na sëmurë, ilaçet do të na vrasin. Ne sot të gjithë jemi dëshmitarë të kësaj.

Ndoshta kjo fatkeqësi mund të bëhet shkak që ne ta rizbulojmë sërish vlerën dhe dinjitetin e njeriut, qëllimin dhe urtësinë e krijimit të tij. Sepse, në një kohë kur garat për matjen e fuqisë u bënë karakteristikë themelore e jetës, pikërisht këtu u mor vesh edhe një herë se në fakt në çfarë terreni të rrëshqitshëm mbështetet kryelartësia e njeriut.

Për njeriun, kjo gjithësi e kjo natyrë u bënë edhe bekim (*ni'met*), por edhe ngarkesë. Krijuesi i Madhërishëm njeriut ia ka dhënë fuqinë dhe potencialin që këtë ngarkesë ta shndërrojë në

mirësi e në bereqet. Njeriu është krijuar me fuqinë dhe potencialin për ta ndryshuar historinë. Sa e sa fatkeqësi kanë ndodhur përgjatë historisë e që njeriu ka arritur t'i kthejë në mëshirë! Nuk ka dyshim se, inshallah, edhe kjo pandemi do të tejkalohet e kapërcehet me dije, me vendosmëri, me gajret, me masa të duhura dhe me mbështetje në Zotin. Njeriu nuk është, siç ka thënë dikush, ujk për njeriun. Njeriu është atdhe e vatan për njeriun. Njeriu është shërim dhe ilaç për njeriun. Kjo ngjarje do të na tregojë neve pikërisht këtë të vërtetë.

Uroj që pasi ta tejkalojmë këtë krizë, njerëzimi do të nxjerrë mësim nga kjo dhe do të bashkohemi të gjithë tok kundër armikut të përbashkët. Kësaj radhe armiku ynë i përbashkët është një virus shumë i vockël. Ndërkaq njerëzimi në të vërtetë ka shumë armiq të përbashkët. Ndoshta krejt kjo që po përjetojmë tani është rezultat i asaj që ne nuk kemi luftuar kundër këtyre armiqve të përbashkët. Kush janë këta armiq? Për shembull, është pasioni për pushtet, është egoizmi, eksploatimi, padrejtësia, injoranca, azdisja, plëngprishja...

Zoti ynë Bujar na e mundësoftë që këtë proces ta kthejmë në mëshirë e mirësi.

Dëshiroj ta përmbyll këtë tekst me lutjen e përjetësuar të prindërve të parë të mbarë njerëzimit:

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٢٣﴾

“Zoti ynë, ne i bëmë padrejtësi vetvetes. Në qoftë se Ti nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi prej të humburve!” (el-A'raf, 7:23)

Mos na bëj prej të humburve, o Zot!

Zoti na e mundësoftë që këtë proces ta kalojmë sa më shpejtë dhe të gjithë pastaj të luftojmë kundër të gjithë armiqve tanë të përbashkët dhe që më në fund të krijojmë një botë krejt të re dhe më të mirë se kjo që po e lëmë pas.

Të gjithë mbetshi nën mbrojtjen e All-llahut të Madhërishëm!

Burimi:

www.ide.org.tr

Nga turqishtja:

Rejhan Neziri